

SHMEK “8 Shtatori”
Revista “EKONOMISTI”



Tetovë, Shkurt 2021

INTERVISTË ME DREJTORESHËN E SHMEK “8 SHTATORI” Tetovë Mirjeta Ilazi



Në fillim e nderuar drejtoreshë dua të ju falënderoj në emër të ekipit që merret me përgatitjen e revistës “Ekonomisti” për kohën që ndatë, dhe pranuat të bëheni pjesë e revistës tonë për mes kësaj interviste. Na keni nderuar shumë. Përmes kësaj interviste besoj se lexuesit do të kenë mundësi që të njihen më shumë me punën tuaj, me të arriturat e shkollës, veshtirësitë që ballafaqohet shkolla sidomos tani në periudhën e pandemisë e kështu me radhë.

Si fillim do kisha dashur të na tregoni kur e keni marrë funksionin e drejtoreshës së shkollës?

Funksionin e drejtoreshës së shkollës e kam pranuar në fund të muajit shkurt të vitit 2019.

Cilat janë veshtirësitë dhe problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet shkolla jonë?

Kemi një numër të madh të nxënësve që e ndjekin mësimin në shkollën tonë dhe fatmirësisht numri i nxënësve të interesuar është gjithmonë në rritje. Infrastruktura e shkollës është shumë e mirëmbajtur dhe gjithmonë përmirësohet. Veshtirësi e cila vlen të përmendet për shkollën tonë është mungesa e hapësirave për zhvillimin e mësimin praktik dhe aktiviteteve jashtë mësimore të cilat aktualisht i zhvillojmë në bodrumet e shkollës ku kemi improvizuar disa ambiente të këndshme për punë edhe pse nuk janë nga më adekuatet, por dëshira e nxënësve për të punuar në aktivitete nuk ka munguar. Punojmë që kjo veshtirësi shumë shpejt të eliminohet me ndërtimin e hapësirave shtesë të cilat shpresojmë se gjatëvitit 2021 do të realizohen.

A jeni e kënaqur me punën e mësimdhënësve, si është bashkëpunimi me ata sidomos tani në periudhën e pandemisë kur mësimi zhvillohet nga distanca?

Shkolla e mesme ekonomike në Tetovë, ka një staf të shkëlqyeshëm të profesorëve të cilët unë i kam kolegë që nga viti 2005, stafin administrativ, bashkëpunëtorët profesional dhe stafin teknik ndoshta është i vogël se atë që e kërkon nevoja, por megjithatë bashkëpunimi është në nivelin e duhur dhe puna ec dhe nuk ngec. I gjithë ky staf që e përmenda më ka pranuar me kënaqësi si drejtoreshë dhe nuk janë shfaqur si pengesë në asnjë rast, por përkundrazi më kanë përkrahur shumë.

Cilat janë projektet shkollore që keni realizuar ju deri më tani?

Për kohën sa jam drejtoreshë në këtë shkollë kam vepruar në të gjitha drejtimet e punës: Në investime për krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e procesit mësimor duke vendosur tabela të mençura në disa mësonjëtoje,

INTERVISTË ME DREJTORESHËN E SHMEK "8 SHTATORI" Tetovë Mirjeta Ilazi

- pothuajse të gjitha klasat kanë tabela të reja magnetike, kemi vendosur dyer të reja në dy katet e objektit të shkollës, kemi furnizuar mjete të nevojshme për zhvillimin e mësimimit me teknologji digjitale, kompjutorë, laptop, projektorë, është bërë lyerja e pjesës së brendshme të mureve të shkollës si dhe aktivite te ku na është dhënë mundësia.
- Jemi regjistruar në Agjensionin Nacional me qëllim që të angazhohemi në projekte ndërkombëtare.
- Jemi në partneritet me një shkollë nga Kosova dhe veç më projekti ku i kemi kyçur 40 nxënës këtyre ditëve duhet të përfundojë.
- kemi qenë pjesë e disa project aktiviteteve të USAID- it ku kemi pasur pjesëmarrës nga shkolla jonë.
- e kemi krijuar Eco Klubin e nxënësve dhe deri sa ishim në gjendje të rregullt kemi pasur shpesh aktivitete me nxënës dhe aktivitete të tjera të kësaj natyre.
- kemi marrë pjesë në olimpijadën arsimore Massum, dhe kemi rezultate të shkëlqyeshme të nxënësve tonë.



Si ka ndikuar pandemia e shkaktuar nga virusi COVID 19 në shkollën tone?

Nga muaji mars i vitit 2020 edhe ne si të tjerët jemi duke vepruar në rrethana më ndryshe. Prej fillimit të periudhës së karantinës dhe izolimit për shkak të virusit korona e deri më sot punën nuk e kemi ndalur në asnjë moment, bile kemi qenë shumë më të angazhuar duke e mbajtur kontaktin me njëri -tjetrin gjatë gjithë kohës. Nxënësit e shkollës tonë mund të themi se nuk e kanë ndërprerë fare procesin mësimor, sepse menjëherë kemi vepruar me krijimin e klasave në classroom dhe vazhdimin e punës me vetiniciativën e mësimdhënësve. Komuna e Tetovës ka qenë nga të parat që e ka nisur mësimin online. Jam e kënaqur me bashkëpunimin që e kemi pasur. Vështirësi ka pasur shumë, të panjohura poashtu shumë po ia kemi dalur me sukses. Gjatë kësaj kohe sa punojmë nga distanca nxënësit nuk i kanë ndalur as edhe aktivitetet për festa me ç' rast kanë realizuar projekte të shkëlqyeshme.

Cili është vizioni juaj për shkollën tonë, në cilat rrugë duhet ecur sipas jush dhe ku duhet përqendruar më shumë për të qenë të suksesshëm?

Ardhmëria e shkollës ekonomike janë nxënësit e suksesshëm dhe të përgatitur mirë. Dëshira ime është që në këtë shkollë të filloj me punë kompania reale e shkollës të cilën ndoshta veç do ta kishim po të mos ishte korona. Në këtë kompani nxënësit do ta kishin realizuar edhe punën praktike me lehtësi, dhe kështu do të ishin më konkurrent në tregun e punës. Dëshira ime është që nxënësit që dalin nga kjo shkollë të jenë konkurrent nëpër projekte botërore. Uroj që kjo të realizohet!

Për fund një mesazh për lexuesit e revistës "Ekonomisti", në veçanti për nxënësit tonë?


E këshilloj gjithë rininë që të punojnë shumë dhe gjithë atë që e dëshirojnë, të punojnë për takrijuar dhe jo të presin që dëshirat e tyre t'i realizoj dikush tjetër.

DITURIA USHQIM I SHPIRTIT

Jeta është e interesante, të tërheq me vete kudo që ti shkon dhe kudo që arrin. Njoftimi përherë të parë me jetën është shumë i vështirë dhe çdo herë i parashtrojmë pyetje vetes athua pse linda unë, u rrita e tash dua te jetoj?! A thua vallë çfarë është jeta?! A thua vallë ka ndonjë mangësi që çdoherë me duket e bukur dhe çdo here bukuria e saj më shndërrit në thëllësi të shpirtit tim...

Pyetje, pyetje, e pyetje çdo here më rrotullohen në kokë por asnjë here nuk mund të gjej përgjigjen e duhur, çdo here vazhdoj të jetoj dhe në mënyrë të pa vetëdijshme bëhem shok me jetën dhe bartem në ato vende ku dallgët e saj më dërgojnë dhe më përplasnin me aq fuqi të forte sa më sjellin në vetëdije, kthjellem dhe mendoj: ku isha?! ku jam?! ku do të jem vallë?!

Atë moment e ndjej që dallgët e jetës nuk me shtyjnë dhe më kanë lënë të vetme, atë moment e ndjej se jam plotësisht e vetëdijshme për atë çka ka ndodhur, për atë çka ndodhi, e jo për atë çka do të ndodh. Për këtë shkak ndalem dhe e pyes jetën: Përse tash më le të vetme, tash kur kam nevojë, më trego rrugën ku do të shkoj, a thua vallë ku do ta gjej veten?! E kur nuk kam nevojë duart e tua nuk më tërhiqen?! Zëri I jetës më tingëlloi thëllë në shpirtin tim, saqë ma ndau zemrën në dysh: Ju lindët pa fuqi fizike, ju u rritët pa vetëdije, ju deritash vazhduat të jetoni pa mos e ditur rrugën se ku do të shkoni. Detyra jonë është që foshnjën ta bëjmë e ta dërgojmë deri në moshën rinore, ndërsa ai le të bëhet njeri që nuk do të ketë nevojë për dallgët e jetës. Andaj largohu nga dallgët e jetës dhe fillo të jetosh e vetme, mos shfytëzo asgjë tjetër për pos dashurisë ,mirësisë respektit. Dituria jote është ajo që zëvendëson dallgë tona, thjesht shfrytëzoi ato dhe vazhdo të jetosh. Këto fjalë aq mallëngjyese më humbën kontrollin aq sa që më shtynë vetëm për para një pasqyre dhe të mendoj: "sa foshnje e vogël kam qenë që s'kam ditur gjë tjetër përpos të qarës dhe të qeshurës"! Sa fëmijë i vogël kam qenë duke mos ditur përse jetoj! Por tash e shikoj veten përpara një pasqyre që tregon se jam rritur, jam bërë një njeri që duhet të vazhdoj të jetoj, pa ndihmën e askujt, pa këshillën e askujt thjeshtë të përdor dituriinë time. Athua vallë çfarë është dituria dhe për çfarë nevojitet ajo? Dituria është dritë që ndriçon natën dhe zbukuron ditën, është edhe jetë që nga ajo varet frymëmarrja e shumë njerëzve të lidhur ngushtë për të. Pas çdo kapaciteti madhor është dituria e disa here përzihet me paditurinë dhe ndodhin problem të shumta. Ajo e stimulon jetën drejt të ardhmes së sigurt dhe e lidh ngushtë me aftësitë e tij si krijesë. Niveli i parë i pjekurisë së njeriut është vetë dituria, që përcakton çdo ndjenjë te tij, e lidh fort për të, e ngushëllon e puth e qorton dhe e orienton nga gjithësia e



mendimeve të a arritura. Dituria është status që nxit monotoninë në çastet e integritit të mendjes në shoqërinë njerëzore.

Nuk është rutinë jo, është kompleks i pasthirrmës së orientuar kah soditjet e reja. Dituria është drita jetës sonë.

Ajo është thesari i vërtetë dituria i nevojitet çdo njeriu sikur buka dhe uji sepse sikur nuk mund të jetosh pa to edhe pa dituri nuk mund të jetosh nga fakti kur të krahasosh veten me dike që është I ditur, duke e vendosur veten në shkallën e të pa diturit. Dituria është thesari i çmuar që duhet ta ketë çdo njeri në jetë. Pra fjala dituri është me domethënie të madhe ajo shumë lehtë shqiptohet por shumë rëndë fitohet. Dituria e bën njeriun të pasur sepse ajo ka vlerë mëmshumë se paraja, dituria fitohet duke mësuar ndërsa paraja është diçka që shkon dhe vjen.

Dituria as blehet, as dhurohet, as nuk vidhet, as konsumohet ajo vetëm fitohet.

SIPËRMARRËSI I SUKSESHËM



Si të bëhesh një sipërmarrës i suksesshëm ?

Së pari le të themi se ç'është sipërmarrja. Sipërmarrja është procesi i fillimit të një biznesi dhe sipërmarrësi është ai që merr parasysh:

- Sigurimin burimeve
- Hartimin e planeve
- Marrjen e përgjegjesive në rast suksesi apo dështimi

Një sipërmarrës i mirë, frymëzon ata që e ndjekin dhe bën që të kenë besim jo vetëm tek ai, por mbi të gjitha te vetja. Mirëpo të bëhesh një sipërmarrës, aq më shumë një sipërmarrës i mirë, nuk është fare e lehtë. Drejtimi me sukses i një biznesi , me të gjithë ulje-ngritjet e tij, është një prej sfidave më të mëdha që mund të përballet një sipërmarrës. Mbi të gjitha, një sipërmarrës i mirë duhet të mendoj si të udhëheqë njerëzit që punojnë me të, apo të përpiqet të gjej stafin më të mirë me të cilin do të punojë dhe duhet motivuar ata. Ja dhe disa hapa që mund të ju çojnë drejt të qenit një sipërmarrës (lider) i suksesshëm:

Komunikimi-Sipërmarrës të ndryshëm, bëjnë metoda të ndryshme, megjithatë e rëndësishme është që skuadra të ketë komunikim, përmes tij pastaj vjen dhe motivimi.

Besoni tek njerëzit-Sipërmarrësi duhet të ndihmojnë njerëzit e tij që mes tyre të krijohet një besim reciprok, veçanërisht kur jemi në të tilla raste ku na duhet besimi në mes vete.

Mbajeni të angazhuar ekipin tuaj-Një sipërmarrës i mirë di si t'i japë sfida grupit të tij. Të motivoj ata që çdo herë që t'ju sjellin ide të reja edhe nëse është hera e parë për to. Në këtë mënyrë, janë gjatë gjithë kohës të angazhuar për t'i bërë gjërat ndryshe, duke sjellë risi.

Motivimi punëtorëve-Gjithashtu motivimi i punëtorëve është një pjesë mjaft e dobishme për kryerjen e punës, punëtori e nxjerr versionin më të mirë prej vetes kur është i motivuar, motivim për punëtorin është orari i punës, kur u japim lëvdata, gjithashtu edhe mjedisi ku punon.

Promovimi-Edhe pas këtyre hapave që kemi përmendur, biznesit gjithashtu i duhet edhe promovim i mirë i tij sepse promovimi është zemra apo parimi kryesor (pas kualitetit gjithmonë) për të bërë sa më shumë shitje.

SI TË SHNDERROJMË NJË IDE NË BIZNES?

Fillimi i çdo ideje biznesi zakonisht tshënohet me super-eksitim. Ju jeni i bindur se ideja juaj është gjëja tjetër e madhe.

Kontakti i parë me klientët ose ekspertët shpesh të çon në pikën e pare të zhgënjimit të plotë. Zakonisht rezulton se dikush nuk ka asnjë të dhënë për klientët, nevojat e tyre, dinamikat e tregut dhe konkurrentët. Asnjë ekip inovacioni nuk është i mbrojtur nga supozimet e gabuara. Çështja kryesore është të mësojmë sa më shpejt që të jetë e mundur. Kjo nën kupton formulimin e hipotezës dhe mbledhjen e reagimeve reale të tregut për të pare nëse jeni në rrugën e duhur. Ndërtimi i biznesit tuaj në bazë të supozimeve të gabuara mund të çojë në gabime kritike në vend të suksesit të madh.

Hapi i parë i madh është të njihni klientin tuaj. Asnjë klient nuk do të thotë asnjë biznes. Përcaktoni segmente kryesore të klientëve që dëshironi të shërbeni mbi punën që ata dëshirojnë të bëjnë dhe tregoni nevojat kryesore që ka nëpër ta bërë këtë. Më e rëndësishmja është të mos e detyroni zgjidhjen. Mundohuni t'i kuptoni vërtetë klientët tuaj. Sa më shumë që i kuptoni klientët tuaj dhe nevojat e tyre, aq vlera më të mira mund të krijoni për ta, dhe kështu bëni biznesin tuaj më të suksesshëm. Mbani në mend se nuk keni pse t'i shërbeni secilit klient. Do të jetë shumë më e lehtë të përqendroheshi në një segment të konsumatorëve dhe të gjeni tregun tuaj të ngrohtë. Edhe pse mund të mendoni se jeni i vetmi nuk jeni. Gjithmonë ka konkurrencë. Por nuk duhet të keni frikë nga konkurrenca për sa kohë që e dini kush janë ata. Për të gjetur vendndodhjen tuaj duhet të identifikoni dhe analizoni konkurrentët tuaj kryesorë. Renditni përfitimet kryesore të rëndësishme për klientët tuaj dhe vlerësoni veten me konkurrencën tuaj.



Kur të jeni të sigurt sekeni identifikuar një treg që është mjaft i madh me një problem që ia vlen të zgjidhet, është koha të krijoni një grup të shpejtë të parashikimeve financiare për zgjidhjen tuaj. Është rëndësishme të shikoni idenë tuaj të biznesit nga këndvështrime të ndryshme për të marrë një perspective tërësore. Gjithashtu mendoni për ngjarje të ndryshme që mund të ndodhin.

MË MIRË I FORTË APO I ZGJUAR?



Në këtë kohë kur po jetojmë, është më mire të jesh i zgjuar se sa i fortë, sepse duke qenë i zgjuar mund të formulosh fjalë të zgjuara, të bësh punë të zgjuara dhe jetë më të mire familjare. Nëse futesh ndonjë here në debate me njerëz "të kohës së sotme" ne e dimë se sa inteligjenca e lartë mund të na ndihmojë, për të pasur një zgjuarsin, për të krijuar debate apo për të thënë fjalë të mençura.

Njerëzit e zgjuar fitojnë me argument majtas dhe djathtas, sepse ata gjithmonë dinë të ballafaqohen me zgjuarsin me kundërshtarët e tyre, jo si njerëzit që merren me sport gjatë një pjesë të jetës së tyre dhe japin deklarata jo inteligjente.

Me siguri keni dëgjuar duke thënë se duhet të jemi më të mirë me ata që punojnë shumë, të cilët quhen "budallenjë" në kohën të cilën po jetojmë, por ata janë mbi ne nuk duhet t'i quajmë ashtu, sepse do të perfundojmë duke punuar për ata një ditë.

Disa njerëz zakonisht kanë kualifikimet dhe intelektin e kërkuar për të gjetur punë më të mira, gjetja e vendeve më të mira të punës mund të ketë të bëjë edhe me mënyrën e të folurit, për shembull mund të bëhesh avokat, ambasador apo edhe të bëhesh skenarist, gjë që kush nuk do ta dëshironte të hynte në një kinema dhe të shikonte aktorët duke interpretuar fjalët e tua.

Njerëzit e zgjuar thjesht kanë prirjen për të gjetur punë më të mira, siç mund ta imagjinojë paratë shkojnë së bashku me këtë, njerëzit inteligjentë kanë më shumë të ngjarë të kenë mundësi për punë të pabesueshme që rezultojnë në pagesa të larta, por një person i dobët sado pak i zgjuar të jetë edhe ai do të ketë guximin të merr rreziqet e nevojshme për të qenë i suksesshem në jetë. Nëse shpresoni të krijoni familje një ditë, mendoni për fëmijët tuaj. Prindërit më të zgjuar zakonisht rezultojnë të kenë fëmijë më inteligjentë, ose për shkak të gjenetikës ose sjelljeve të mësuara. Krijimi i një brezi të rri intelektualësh mund të jetë i mirë vetëm për njerëzimin në tërësi, kështu që kalimi i zgjuarsisë tuaj te fëmijët tuaj është gjë interesante e cila në të ardhmen do të ndikoj pozitivisht. Dhe të mbajmë mend, pa njerëz të zgjuar nuk do të kishim kurime për sëmundje, të gjithë do të vuanim kur dielli të zgjerohej, dhe të gjithë do të ishin të mjeruar ose të vdekur. Forca nuk zgjidh asnjë nga ato probleme, kështu që forca është padyshim inferiore ndaj inteligjencës, sepse pa zgjuarsinë, të gjithë ne do të ishim të humbur përjetësisht.

Mirëpo në jetën e sotme shohim shumë njerëz të cilët mburren me forcën e tyre. Disa mendojnë se po të jesh i fortë mund të zgjidhësh gjithçka, disa të tjerë mendojnë se po të jesh i zgjuar do të përballosh shumë mirë jetën.

Kemi për para dy persona njëri përfaqëson forcën, e tjetri zgjuarsinë dhe jemi përballë një zgjidhjeje.

Kjo na tregon se cilët duhet të jemi ne, të fortet apo të zgjuarit.



“Lufto, çdo ëndërr do të të bëhet realitet”

Çdo ditë e jetës na shoqëron me nga një sfidë, të gjithë ne kemi ëndrrat tona dhe të gjithëve ndonjëherë na kanë dështuar, mirëpo më e rëndësishmja është që ne të mos heqim dorë dhe të mos dorëzohemi asnjëherë nga ëndrrat tona por tël uftojmë për ato sepse çdo ëndërr do të të bëhet realitet. Kemi një jetë përpara që do të na sprovtojë në mënyrat e ndryshme, mirëpo të gjithë ne duhet të gjejmë forcën për brenda vetes dhe të luftojmë për qëllimet tona, për ëndrrat që duam të na bëhen realitet. Arsye ka shumë për të ndaluar rrugën tone drejt ëndrrave mirëpo ne të gjithë duhet t’l eliminojmë ato, duhet ta sfidojmë veten edhe në moment të rrezikshme dhe të fitojmë.

Endrrat e bëra realitet pa u munduar janë shume të kota dhe një mendim i paarsyeshem sepse pa bërë punë dhe pa lufuar për atë ëndërr që duam nuk mundemi t’ia arrijmë asnjëherë, nuk mundemi te ecim para. Gjithsesi i dobëti gjithmonë l gjen gabime çdo elementi duke e menduar çdo ditë dhe natë rrugën që ka ngecur dhe pa bërë asnjë hap përpara për të bërë realitet ëndrrën e tij. Për ëndrrat tona duhet të përpiqemi shume që të arrijme aty ku duam dhe më e rëndësishmja është që nuk duhet të heqim dorë asnjëherë dhe mos të bëhemi të dobët mirëpo të jemi të forte, të gjejmë forcën Brenda vetes, të sakrifikojmë për atë që ne duam. Kudo në botë gjenden tipa të ndryshëm njerëzish, disa që ëndërrojnë dhe punojnë që ëndrrat tu bëhen realitet, dhe disa që ëndërrojnë para se të flejnë. Mbi të gjitha e ardhmja u përket atyre që besojnë në ëndrrat e tyre, sepse nëse mund të ëndërrosh mund edhe të realizosh.



JETA

Jeta është e gjatë për të jetuar dhe e shkurtër për të pritur, pra nëse t'1 dëshiron të bësh diçka dhe me atë që do nuk dëmton askënd atëherë bëje atë, mos u mërzit për fjalët që do do të dëgjosh për ty nga njerëzit që nuk din si të jetojnë, sepse edhe nëse ti u ofron atyre perfeksion ato akoma mund mos ju pëlqejnë pra mos u mërzit jeto me kornizat që i ke caktuar vetes, me sakt ji i ndërgegjeshëm. Siç ne e dim jeta ka moment të mira, moment të vështira edhe momente shumë të rënda por jeta nuk thotë që përshkak të këtyre momenteve të jemi të dëshpëruar, është zgjedhja jonë nëse ne rrim të mërzitur nuk është faji i jetës por është i joni sepse ne nuk jemi mësuar që të vlerësojmë gjërattona positive në jetë. Nërregull, ka disa moment kur ndonjëherë dikush prej nesh nuk mund ta kontrolloj veten e tij të trishtuar por nuk mund të zgjat me ditë, javë ose edhe me muaj ky trishtim, nëse zgjat më shumë pra është faji jonë por nuk domethenë që është vonë të bësh diçka për veten tënde.



Mësohu që ti ke lindur vetëm dhe ti do të vdesësh vetëm gjithashtu pa mos patur dike afër nesh pa mos ndjer nevojën që të ndajmë dhimbjendhe gëzimin me dike sepse jeta është e mbushur plot me befasi dhe jo të gjitha befasitë do të na pëlqejnë mund të ndodh që personi më i afërt që ti ke, të të braktis pavarësisht nëse është zgjidhje e tij ose jo që të mos shkojmë deri në dëshpërim, zhgënjim, edhe në dëshpërim ne duhet të pranojmë faktin që ne jemi vet. Nga jashtë shumica nga ne nuk dukemi vetja sepse jemi të rrethuar nga shoqëria edhe shoqëri të ngushtë sa që ti bën gjithcka me ta, ata janë një rreth i vogël dhe ne dim gjithcka për njëri-tjetrin, të paktën ne mendojmë kështu sepse gjithkush nga ne pa marrë parasysh sa shokë kemi, ndjenat e tyre mund të jenë secrete sa që askush nuk mund t'1 shoh ato dhe nga kjo vjen ajo që ne duhet të marrim një vendim rreth këtyre njerëzve. Nga kjo që unë thash do ja të tregoja që ne duhet të ndjehemi të kompletuar vetëm pos kësaj nëse ne kemi shoqëri ose njerëz të afërt është bonus për ne. Ndonjëherë nuk ka nevojë për shumë seriozitet ne jetojmë me shpresa, ka edhe net më të errëta, ka dritë në kohërat e mira vijnë dhe asgjë nuk është më e rëndësishme se ti!

Omer Xheladini III-9

Familja ime

Kur fjalët dalin nga zemra janë shumë të pakta dhe rrallore, të shkruash për familjen s'do mundja kurre te dilja ne ndonjëpërfundim konkret, sinqerisht familja është besimi, është lumturia , është dashuria, është paqja, është ushqimi i shpirtit , është dëshira , është qartësia dhe më saktësisht është kështjella ime që projektuan prindërit e mi dhe mbanë gjallë themelet e këtij kafazit të artë që ne frymojmë brenda.

Gjuha e zemres është ndaj sot unë vendosa te Çdo herë në dialogje të pyetja që ka të bëjë me të është mardhënja juaj me pasuri, a je ti e aftë në përgjigja ime është ndihem superiore në atë Jam njeriu më i pasur në do më ndjekin deri në të gjithë! Po si ka



me gjithë perfshiresja, shprehem me të..

ndryshme vjen edhe dhënat personale : “Si të ardhurat?” Pra, a ke jetë?- Dhe gjithmonë modeste dhe mëbën të çka e them qëështë: “ botë, me të ardhura që fund të jetes”. I habitë mundësi një vajzë

adoleshente dhe e vogël siç jam unë të ketë aq fitime në jetë. Përtej asaj që u pergjigja unë dhe asaj se ç’kuptuan bashkëbiseduesite mi përgjigja ime konkrete dhe e sinqertë është kjo: “Jam shumë e pasur, kam familje mrekullushme , ata janë pasuria ime, janë e ardhmja ime , janë gjithçka që posedoj unë në këtë bote. Dhe derisa unë ta kem dashurin e tyre në këmbim të asaj që une përpiqem nëçdo mundësit’ua dhuroj atyre , jam një miliardere e sukseshme që ka arritje shumë te mëdha.

Sot vendosa të shkruaj për lumturin time , sinqerisht më mjafton vetëm një çastë për ta vulosur se familja është ajo normë ajo rregull që të qartëson , të bën të mendosh, të ndryshosh, të marrësh përgjegjësi, me një fjalë të bën një njeri të denjë e human që i duhet botës sot.

DËSHTIMI SI FENOMEN


Sa dhemb dështimi kur punon fort dhe nuk e arrin qëllimin?

Është një pyetje që çdo njeri ia bën vetes, një sfidë që çdo njeri e përjeton por janë të rrallë ata që arrijnë të kthehen në nivelin që kanë qenë pasi që bart me vete pasoja të rënda shpirtërore. Për shkak të dështimit shumë njerëz kanë humbur gjëra të vlefshme si p.sh. punën, shëndetin, njerëzit e dashur etj, por ajo që është më e vlefshme është koha që humbëm. Cdo njeri ndonjëherë në jetë e ka provuar dështimin mirëpo asnjëherë nuk duhet të mendojmë që është një shenjë dobësie, sepse është thjesht një pengesë që na pengon drejt suksesit. Përmes dështimit ne arrijmë ta mësojmë më mirë vlerën e suksesit dhe do të përpiqemi ende më fort për t'i realizuar qëllimet tona. Duhet ta kuptojmë që dështimi më i madh në jetë është dorëzimi dhe gjithmonë duhet ta kujtojmë arsyen pse e filluam.

Uroj çdo kush që e ka përjetuar këtë fenomen të arrij të rikthehet, pasi që jeta është një rrugë embushur me plot probleme e dështime, neve na mbetet që të mos dorëzohemi kurrë, të tregohemi të guximshëm dhe këmbëngulës nëse duam të arrijmë qëllimin që i kemi caktuar vetes në jetë.



KANCERI, SFIDA MES JETËS DHE VDEKJES



Ka një numër të madh të sëmundjeve që mund t'i gjejmë në botë. Disa prej tyre kanë shërim dhe disa prej tyre janë duke i mbytur njëzëit për vite me radhë. Një prej këtyre sëmundjeve të rënda dhe vdekje prurëse është padyshim kanceri që mund të shfaqet në pjesë të ndryshme të trupit, është përgjegjës për një përqindje të lartë të vdekjeve që ndodhin në botë.

Megjithëse ka shumë lloje kanceri, të gjitha fillojnë si rezultat i rritje sa normale dhe të pakontrolluar të një qelize të vetme. Organizmi ynë është i përbërë nga një numër prej trilionë qelizash të gjalla.

Qelizat normale të organizmit të njeriut rriten, ndahen dhe vdesin sipas një rregulli të programuar ndërsa sëmundja e kancerit është rezultati i ndarjes së pakontrolluar të qelizave që nuk vdesin. Një qelizë normale shndërrohet në një qelizë

kanceroze për shkak të dëmtimit të DNA-së saj. Kanceri mund të zhvillohet edhe nga gjenet. Sëmundja e kancerit mund të shërohet dhe të kurohet por ndonjëherë mund ta marrin përsëri. Tra-

jtimet bëhen me kimoterapi, radioterapi, terapi me laser dhe kirurgji. Simptomat e kancerit që nuk duhet injoruar janë humbja e peshës, ndryshime në tretje, lodhje, dhimbje në fytyrë, ndryshimet në lëkurë, gjakderdhjet e çuditëshme, vështirësi në gjëllitje, depresioni dhe dhimbjet e barkut. Llojet e kancerit të cilat janë më të përpahura janë: kanceri i gjirit, kanceri i mushkërive, kanceri i stomakut, leukemia, kanceri i limfatit, kanceri i mitres e shumë të tjera. Më 14 shkurt është dita ndërkombëtare e luftës kundër kancerit për të ndaluar miliona vdekje që ndodhin në vit dhe për të rritur vetëdijësimin dhe edukimin e rinisë së sotme për sëmundjen e kancerit. Në duhet ti kushtojmë rëndësi dhe kujdes të madh shëndetit tonë, nëse na paraqiten ndonjë simptomë që ka lidhje me kancerin duhet që ta vizitojmë mjekun, të mos i anashkalojmë simptomat dhe ta parandalojmë sëmundjen e kancerit sa më herët.



MODA,SA TE RINJTE TANE KANE MUNDESI TE NDJEKIN MODEN

Moda është një term që zakonisht përdoret për të reguar një stil veshjeje, e cila është përhapur gati në të gjitha vendet e botës. Në ditët e sotme fjalë mode ka një vlerë të madhe në jetën e secilit prej nesh. Moda ndiqet pothuajse nga të gjithë, sidomos nga të rinjtë, duke filluar nga ata njëzë që bëjnë jetë më të thjeshtë deri tek ato më të pasurit



Zakonisht moda nuk shfrytëzohet vetë për të treguar mënyrën se si vishesh, por për shumicën e njerëzve ajo përdoret edhe për të shfaqur personalitetin e tyre si dhe për të rritur vlerat e tyre në shoqëri. Femrat janë ato të cilat janë të dhëna më shumë pas modës, duke u inspiruar nga njerëzit ose figurat e rëndësishme publike të cilët ato i adhurojnë.

Mirëpo në përditshmërinë tonë jo të gjithë i kanë kushtet e barabarata për të ndjekur modën dhe trendet botërore. Fundja çdokush duhet të jetë i lire në zgjedhjet që bëjnë, të vishet dhe të jetojë si dëshiron edhe nëse ajo veshje nuk është e modes së fundit, mjafton që ai ose ajo të ndjehet komod në veshjen e tij/saj, kurse neve na mbetet mos bëhemi paragjykes.



SHKELZEN DOLI VIOLINISTI SHQIPTAR I FAMSHËM NË BOTË

Shkëlzen Dolilindi më 9 gusht 1971 në Elbasan (Shqipëri), mësimet e para për violin filloi t'i marrë në moshën 9-vjeçare në qytetin që u rrit, Gjakovë (Kosovë). Fitorja e disa çmimeve në konkurset rajonale bëri që në vitin 1986 të merrte një ftesë për t'u regjistruar në Gjimnazin e Muzikës të Novi Sadit, institucioni më i shquar i këtij lloji në ish-Jugosllavi. Aty ai ishte nxënës i pedagogëve hungarezë Imre Jambor dhe Csaba Szima. Në moshën 17-vjeçare fitoi çmimin e parë në Konkursin Kombëtar të Muzikës për të rinjtë në ish-Jugosllavi dhe pas kësaj u regjistrua në klasën e Ewgenia Tschugaeva-s në Akademinë Muzikore të Novi Sadit. Më 1995 karriera e Shkëlzen Dolit si muzikant shënoi një sukses të ri shumë të rëndësishëm: ai filloi të luante në Orkestrën Filarmonike të Vjenës. Njëkohësisht vazhdonte studimet në Universitetin për Muzikë dhe Arte Figurative të Vjenës. Që atëherë stili dhe ngjyra tingullore e Filarmonisë së Vjenës kanë qenë vendimtare për të si violinist. Pjesëmarrja në ansambletë ndryshme filarmonike të muzikës së dhomës, si p.sh. te "Toyota Master Players", "Virtuozët Vjenezë" dhe Rene Staars "Ensemble Wiener Collage", "The Philharmonics", e ndihmoi Shkëlzen Dolin të zinte një vend të përhershëm dhe të suksesshëm në skenën muzikore vjeneze. Ka qenë në shumë turne si solist dhe anëtar i grupeve të muzikës së dhomës në shtete të ndryshme evropiane, në Amerikën Veriore, Afrikë, Izrael dhe Japoni.



Ai bën pjesë edhe në një grup të sapo riformuar të muzikës së dhomës, në ansamblin "Philharmonisches Ensemble - Wien".

Universitetin për Muzikë dhe Arte Figurative të Vjenës. Që atëherë stili dhe ngjyra tingullore e Filarmonisë së Vjenës kanë qenë vendimtare për të si violinist. Pjesëmarrja në ansamble të ndryshme filarmonike të muzikës së dhomës, te "Toyota Master Players", "Virtuozët Vjenezë" dhe Rene Staars "Ensemble Wiener Collage", "The Philharmonics", e ndihmoi Shkëlzen Dolin të zinte një vend të përhershëm dhe të suksesshëm në skenën muzikore vjeneze. Ka qenë në shumë turne si solist dhe anëtar i grupeve të muzikës së dhomës në shtete të ndryshme evropiane, në Amerikë Veriore, Afrikë, Izrael dhe Japoni. Ai bën pjesë edhe në një grup të sapo riformuar të muzikës së dhomës, në ansamblin "Philharmonisches Ensemble - Wien" Universitetin për Muzikë dhe Arte Figurative të Vjenës. Që atëherë stili dhe ngjyra tingullore e Filarmonisë së Vjenës kanë qenë vendimtare për të si violinist. Pjesëmarrja në ansamble të ndryshme filarmonike të muzikës së dhomës, si p. sh. te "Toyota Master Players", "Virtuozët Vjenezë" dhe Rene Staars "Ensemble Wiener Collage", "The Philharmonics", e ndihmoi Shkëlzen Dolin të zinte një vend të përhershëm dhe të suksesshëm në skenën muzikore vjeneze. Ka qenë në shumë turne si solist dhe anëtar i grupeve të muzikës së dhomës në shtete të ndryshme evropiane, në Amerikën Veriore, Afrikë, Izrael dhe Japoni.



SHKELZEN DOLI VIOLINISTI SHQIPTAR I FAMSHËM NË BOTË

Ai bën pjesë edhe në një grup të sapo riformuar të muzikës së dhomës, në ansamblin "Philharmonisches Ensemble - Wien" janë pasionet, e shumë detaje që nuk i keni njohur më pare për Shkëlzen Dolin. Ëndrra ime personale si violinist me formim klasik u realizua në momentin kur u bëra anëtar i Orkestrës më prestigjioze në botë, "Filarmonisë së Vjenës. Por ëndrra ime më sublime si shqiptar u bë e prekshme kur shlyeva një detyrim moral si shqiptar; Prezantimin e muzikës shqiptare në sytë e mbarë botës. Energjia dhe ndjesitë që qarkullojnë në çdo koncert me kahje nga artisti tek publiku dhe anasjelltas janë gjithë here të veçanta, por me publikun në Tiranë kjo energji është më intense se kudo tjetër. Nëse jep ndjesi të singerta perms interpretimit ajo të kthehet dyfish.

Por ka një përjetim të dyfishtë pasi sa janë të dashur, aq mund të jenë edhe kritikë. Kjo është gjë shumë positive pasi është stimuluese dhe përgjegjësi për artistët shqiptarë dhe të huaj, kur ngjiten në skenë para publikut shqiptar që të jenë gjithmonë në nivel të lartë prezantimi. Rrënjët janë jo thjesht gjaku që të vlon ndër deje por edhe gjithë informacioni gjenetik i kujtesës kolektive të paraardhësve.

Sigurisht, për mua është gjithçka, formimi, edukimi dhe kultura që marrim nga prindërit, rrethi dheshoqëria janë vendimtare jo thjesht në skalitjen e karakterit por edhe në paracaktimin e të ardhmes. Besoj jo vetëm e imja, por për shumë muzikantë një ëndërr do të ishte për jetimi edhe njëherë 'live' i zërit të të papërsëritshmit Luciano Pavarotti në Operan e Violinisti shqiptar Shkëlzen Doli do të interpretoje një concert madhështor në Tetovë. Me rastin e 5 vjetorit të Festivalit "Skena e Muzikës Serioze Shqiptare", Shoqata Alegretto do të organizojë një koncert me virtuosin e muzikës shqipe.



FJALE TE URTA

"Shpërndani dashuri kudo që shkoni. Mos e lejo askënd të vij tek ju dhe të mos largohet i lumtur."-Nënë Tereza

"Është në kohët tona më të errëta që duhet të fokusohem më shumë të shohim dritën."-Aristoteli

"Shpirti shërohet nga prania e fëmijëve."-Fjodor Dostojevski

"Asnjëherë të mos vuash, është të mos jesh asnjëherë i bekuar." -Edgar Poe

"Çdo here bëhu poet, edhe në prozë."-Sharl Bodler

"Imagjinata është më e rëndësishme se dituria." -Albert Ajnshtajn

"Nuk ka asgjë më të fuqishme në botë se një ide që erdhi në kohë."-Viktor Hygo

"Realiteti krijohet nga mendja, ne mund ta ndryshojmë duke e ndryshar mendjen." -Platoni

"Triumf nuk është çdo here të fitohet beteja, por të ngrihesh çdo here që do rrëzohesh." - Napoleon Bonaparta

"Kur të jesh i zemëruar, mendja është e turbulluar, bëj durim sa të kullohet, se njeriu pastaj pendohet." -NaimFrashëri

NJËSI FRAZELOGJIKE
(Të mbledhura në fshatin Dëbërc)

1. Udhës shkurt mos i bjer.
2. Mos u boën ujk në shtëpi, e kinxh në rrugë.
3. Punë punë natë e ditë që të shohim pakës dritë.
4. Punën e sotshme mos e le për nesër.
5. Ondra nuk bohet realitet, pa me u mundau vetë.
6. Ma mair ni dreç i joti, se sa ni melaqe e huj.
7. Kosin e prajshën uji, burrin e prajshën huj.
8. Jetim nuk o ai xhi ska prind, po ai xhi ska mend.
9. Ma mair me t'shai mençmi se me t'livdau budalla.
10. Kush di ma shaum, folën ma pak.
11. Paret të bojn t'pasur, edukata t'bon zotnoj.
12. Mos u bon mendemadh po rai ai xhi ije.
13. Ngat drunit t'thatë, dixhet ene i njomi.
14. Gratë flokët e gjata mend e shkurta.
15. Njerzit largohen, kur mbarojn interesin.
16. Kur vajn mend, hikin dhent.
17. Inatin e natës line për n'mëngjes.
18. Mos vendos kur ije nervoz.
19. Ujku kimen e ndron po zanatin se harron.
20. Njerëzit e fortë rrallë kan një të kaluar të lehtë.

Motër

Je e vetmja që m'kupton
Motra ime sikur yll
Do tkem pranë gjithmonë
Nëlumturi e vështirësi.

Po shkruaj e mendoj
Edi se çdo herë ty m'kujton
Je e vetmja që më qetëson.

Dhurata ime më je ti
Nuk të ndroj as me flori
Sikur botën të m'a falin
Mallin për ty s'mujn tma ndalin.

Sytë me lotë po më mbushen
Se ti je larg nga këtu
Dije motra ime që të dua shumë.

Zemra

Zemra është ajo
Që prap funksionon
Sa herë që lëndohet
Ajo prap punon.

Sa herë që ajo thyhet
Ajo mbijeton
Për ato persona Që duan
përgjithmonë

Ajo zemër që digjet
Ka shumë mërzi
Por do të vij dita
Do të ndjej dashuri.

Si është jeta e një futbollisteje të re ne vendin tonë

Sporti është veprimtari njerëzore qëllimi i të cilit është argëtimi dhe zhvillimi apo krahasimi i aftësive psikike dhe fizike.

Sporti si aktivitet përfshinë aftësitë mendore dhe fizike të njeriut me qëllim zhvillimin dhe përmirësin të tyre.

Jeta e një sportisti/e

Jo çdo kush mund ta jetojë jetën e një sportisti/e sepse në disa raste mund të themi se është pak sa e “vështirë apo e ngarkuar”. Mendoj se njerëzit që nuk merren me sport, nuk mund ta kuptojnë jetën e një sportisti/e e sidomos kur është fjala për sportiste femër, nuk e kuptojnë thelbin apo domethënien e sportit, sporti është art në vete, të jep lumturinë që se gjen në asnjë vend tjetër, vetëm ai që merret me ndonjë sport e kupton këtë ndjenjë.

Fillimet e karrierës

Unë jam Anida Idrizi 17 vjeçare e lindur më 01.11.2003, nxënëse e vitit të tretë në SHMEK”8 Shtatori” në Tetovë, njëherit jam dhe futbolliste profesionale, së fundmi lojtare e Klubit K.F.F “Shkëndija” gjithashtu jam edhe pjesë e Kombëtarës së Maqedonisë U19 femrat. Mendoj se një përqindje e vogël e sportistëve në përgjithësi në vendin tonë e kanë pasur të lehtë fillimin e karrierës si futbolliste, sepse duke marrë parasysh se në çfarë vendi jetojmë dhe çfarë kushte kemi, e mbi të gjitha paragjykimet për një sportiste femër posaçërisht futbolliste është shumë e vështirë. Fëmijëria ime më kaloigjithmonë duke luajtur futboll në shtëpi edhe në lagje. Një ditë rastësisht babai im ishte takuar me një stërvitës të djemve dhe ai i kishte treguar se më ka parë mua duke luajtur dhe ia kishte sugjeruar një ekip futbollit femrash, ku unë mund të filloj të ushtror edhe profesionalisht futbollin, dhe kështu që në moshën 9 vjeçare fillova ta jetoj



ëndrrën time.

Fillimet në klubin e parë K.F.F “Sharplaninka” për mua kanë qenë paksa të vështira, nuk mund të them se kisha paragjykimet, por kishte njerëz që habiteshin se si një vajzë luan futboll, nuk ndikonin aspak këto fjalë tek unë sepse mua ëndrra po më bëhej realitet dhe kjo për mua ishte më e rëndësishme se paragjykimet e njerëzve. Një ndër pjesët mund ta quaj më të vështira gjatë kësaj periudhe për mua ishte ajo se unë isha në një ekipë maqedonase, problemin e parë e kisha të gjuha maqedone, nuk e kuptoja por me kalimin e kohës e mësova edhe gjuha nuk përbente më problem për mua, ishin edhe ato momentet që nuk isha mësuar me aq shumë angazhim në punë, por çdo fillim është i vështirë, mirëpo kur një punë e bën me përkushtim dhe dashuri vështirësitë tejkalohen më lehtë.

Në ekipin e K.F.F "Sharplaninka" isha deri në moshën 13-14 vjeçare deri sa në vitin 2017 u hap një klub futbollistik Shqiptarë për vajza K.F.F Tetova 2017 në të cilin u bëra pjesë e tij.

Si çdo skuadër tjetër edhe ne pretendonim të arrinim majat, kishim shumë suksese dhe arritje u zhvilluam si klub por edhe si në lojtare profesioniste, sukseset ishin të një pasnjëshme. Ne si klub i vetëm shqiptar jo vetëm në Tetovë por në të gjithë Maqedoninë kemi thyer tabu në vendin tonë.

Pjesëmarrja ime në Kombëtaren e Maqedonisë ishte deri si e pa pritur dhe sfiduese, mirëpo unë punoja me përkushtim shumë të madh dhe ja arrita, por edhe pa dyshim i falënderohem klubit për



për ndihmën dhe përkrahjen.

Pas një kohe, për disa arsye klubi vendosi ta ndryshoj emrin K.F.F "Shkëndija", sukseset, arritjet më të mëdha i kishim në këtë periudhë prej ndryshimit të emrit sepse bartnim një emër që domethënë shumë për vendin tonë.

Sa i përket Kombëtares ka më shumë se 2 vjet që

jam pjesë e saj U17 tash U19, kam luajtur shumë ndeshje si në vendin tonë ashtu edhe jashtë.

Koha e pandemisë sigurisht na ka shkaktuar edhe neve problem të madh sidomos në kohën e karantinës, kur nuk mund të stërviteshim, na ndërpreu kampionatin sezonal për disa muaj, dhe kjo ishte pak sa e vështirë për ne sepse nuk jemi mësuar të qëndrojmë aq kohë pa stërvitje dhe pa ndeshje. Mbetem me shpresë se kjo situatë e shkaktuar nga pandemia të kalojë së shpejti dhe ne t'i kthehemi jetës normale, stërvitjeve dhe ndeshjeve të shumta që na presin. Në fund këshilloj të gjitha vajzat e reja që ju pëlqen sporti, të luftojnë dhe punojnë për të realizuar ëndrrat dhe dëshirat e tyre. Çdo punë sado e vështirë dhe e paarrtshme të na duket nëse ekziston vullneti dhe motivi për ta bërë, bëhet e mundur.

EKLENT KACI SPORTISTI I DALLUAR I BILARDOS

Eklent Kaci apo Klenti Kacii lindur me 29 janar vitit 1999 në qytetin e Laçit të Shqipërisë, ka filluar të merret me sportin e bilardos që nga moshë 8 vjeçare, kur ai luante bilardo me shokët e lagjes. Kur ishte 11 vjeç ai ka marrë pjesë për herë të parë në Kampionatin Kombëtar për të rinj duke u shpallur kampion për kategorinë U18. Në moshën 13 vjeçare ai u kërkua t'i bashkangjitet Federatës së Snukerit të Shqipërisë dhe fitoi Kampionatin Kombëtar të Snukerit. Si 14 vjeçar Kaci u shpall kampioni bilardos në Shqipëri në të gjitha kategoritë dhe vazhdon të jetë kampioni i bilardos në Shqipëri. Prej në moshë të re vazhdoi rrugëtimin e tij si kampion duke shtuar kupat dhe medaljet në disiplina të ndryshme duke e kthyer këtë lojë në pasionin e tij më të madh. Ai u shpall kampion fillimisht në Shqipëri dhe Kosovë por më pas filloi të fitoj kampionate Evropiane në Romani, Turqi, Itali, Rusietj. Kjo i dha Eklentit forcë për të kapërcyer kufijtë evropian për të fituar kampionate në SHBA me katër rekorde botërore duke u bërë i pari që është renditur në historinë botërore të bilardos në të gjitha renditjet ndërkombëtare.

Pasioni i Eklent Kacit duke e kthyer kenaqësinë e një loje në një fitore absolute e bën Eklentin përfaqësues dinjitoz të Shqipërisë në nivele botërore të të gjitha disiplinave të bilardos.

Në moshën 18 vjeçare Kaci u rendit në vendin e parë botëror në disiplinën 9-she dhe vendin e tretë në disiplinën 8-she. Një nga momentet më krenare në karrierën e tij ishte pjesëmarrja në turneun me prestigjioz të bilardos "Mosconi Cup" në vitin 2018. Në Mosconi Cup marrin pjesë 5 lojtarët më të mirë të Evropës kundër 5 lojtarëve më të mirë të SHBA-së dhe luhet cila skuadër mbledh 11 pike të parët, turneu është vjetor dhe Kaci për 3 vite radhazi është zgjedhur të përfaqësoj ekipin e Evropës në Mosconi Cup, që këtë vit Evropa e fitoi në mënyrë dominuese 11-3.



Një gjë që bën Eklentin një lojtar të shkëlqyeshëm të bilardos është se ai ka fituar kampionate në plot disiplina të bilardos siç janë: 8-she, 9-she, 10-she dhe 14.1. Ai gjithashtu bëri të pamundurën në vitin 2017 në kampionatin Derby City Classic ne SHBA ku mundi legjendën e sportit të bilardos “EFREN REYES” prej Filipinos që është shteti ku praktikohet sporti i bilardos më shumë në botë.

Ky sukses i madh dhe i shpejt është vetëm fillimi për Eklent Kacin që është 21 vjeç, kjomoshë është mosha mesatare që plot bilardistë e kanë filluar karrierën e tyre të bilardos. Eklent Kaci është një sportist i shkëlqyeshëm, një inspirim i madh për të rinjtë e bilardos anë e mbanë botës dhe një inspirim më i madh për shqiptarët.


Albi Idrizi III-9

**Kryeredaktor
Elma Bexheti**



**Menaxhimi
Fadlan Kadrija
Mirjeta Durmishi
Donart Ismaili**

**Një falënderim të vaçantë
deri te profesoret që
ndihmuan në përgatitjen
dhe realizimin e revistës:
Zira Agushi
Asibe N. Salihi
Fatmire Elmazi**

Disa nga aktivitetet dhe projektet e zhvilluara në shkollën tonë gjatë muajit dhjetor dhe janar



Vizite e befashme dhe shumë e këndëshme nga profesori i nderuar Petrit Pollozhanj
Autori na dhuroi nga librat e tij, titujt:
Mikroekonomia;
Makroekonomia;
Hyrje në ekonomi.
Faleminderit shumë që na e pasuruan bibliotekën tonë!
Ne ju dëshirojmë suksese pafund!



Për ndikim pozitiv, me plot dashuri për ju nxënës dhe kolegë të respektuar ❤️!

Me iniciativë të profesoreshës Lirida Arallani një donator nga diaspora (Monieur Selmani) i siguroi dhuratë për nxënësit e shkollës ekonomike në Tetovë që nuk kanë mjete për mësim nga distanca. Faleminderit shumë për këtë iniciativë humanitare të profesoreshës dhe urrejmë jetën më të mirë për të gjithë që kanë mundësi të japin kontribut!

